25 PY. Dëshmitar, kjo është një përmbledhje e asaj që keni thënë

1 ju edhe gjatë seancës përgatitore. Ajo që keni thënë ju është
2 paraqitur saktësisht.

3 Dëshmitar, në të shkuarën katër herë i keni thënë UNMIK-
4 ut dhe ZPS-së, pra UNMIK-ut në 2002 dhe ja keni thënë të
5 njëjtën gjë dhe ZPS-së në 2020 se ju i keni bërë një propozim
6 Sadik Halitjahës, ja keni bërë propozimin, pra që ta lironin
7 Latife dhe Rushe Kolollin. Tani, unë po ju bëj këtë pyetje:
8 Pse po thoni të kundërtën tani, pse po e ndryshoni këtë?
9 PË. Nuk po e ndryshoj. Na e bisedum edhe para një jave. Unë
10 gjithmonë kam aluduar në shtabin e batalionit. Batalioni ka
11 pas shtab. Edhe unë kam thënë se ju kam propozuar dy emrat që
12 i përmendëm më herët që të lirohen. Ata pastaj me kënd kanë
13 bisedu unë nuk e di, as që kam mujt me e dit.

14 PY. Nëse po e kuptoj unë siç duhet, ju po thoni që ju
15 personalisht propozuat që të liroheshin ose të transferoheshin
16 këto gratë tek brigada dhe këtë propozim ja keni bërë shtabit
17 të batalionit, kështu?

18 PË. E kam bë, ja kam bo Agim Zybës edhe Naim Kadollit. Se me
19 ata jam marrë unë, nuk jam marrë me tjetërkënd.

20 PY. Dëshmitar, siç thashë pak më herët, ju keni bërë katër
21 deklarata për UNMIK-un edhe për ZPS-në edhe të katërta herët
22 keni thënë që keni bërë propozim që të lirohej Latife dhe
23 Rushe Kololli ose të transferoheshin në batalionin e Sadik --
24 ose -- më fal, ose të dërgoheshin në brigadën e Sadik
25 Halitjahës. Ju lutem, a mund ti thoni Trupit Gjykses pse po e

1 mohoni që e keni thënë këtë në katër raste të ndara?

2 PË. Unë gjithmonë thashë që kam aluduar në shtabin e
3 batalionit jo në personat konkret. Unë kam biseduar me Agim
4 Zybën dhe Naim Kadollin. Ata pastaj kanë qenë që kanë biseduar
5 a s'kanë bisedu, nuk di. S'kam pas unë për detyrë me bisedu me
6 kërkënd tjetër. Mendimi im ka qenë i prerë të lirohen sepse
7 nuk ka elementet të rrezikshmërisë nga ato dy persona.

8 PY. Dëshmitar, të jemi të qartë se kjo është e rëndësishme,
9 pra ju po thoni që unë në të shkuarën nuk ja kam dhënë, nuk ja
10 kam bërë Sadik Halitjahës këtë propozim, po e mohoni këtë?

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Kundërshtoj. I nderuar Gjykatës,
12 kam frikë se këtu po bëhet një diskreditim i deklaratës së
13 rregullës 154 e tani jemi në një procedurë shumë delikate.

14 Prokuroria përmes paraqitjes së deklaratave përmes
15 rregullës 154 ata, Prokuroria del në përfundimin se dëshmia
16 sipas rregullës 154 nuk është e rreme. Dhe nuk mund të
17 diskreditohet një deklaratë që paraqitet për vërtetësinë e
18 përmbajtjes së vet tek provat gjyqësore. Kjo është e shprehur
19 shumë qartë në nenin 14(3) të Kodit të Sjelljes. Nëse
20 Prokuroria tani po thonë që disa pjesë të deklaratave nuk kanë
21 qenë të vërteta atëherë sipas meje Prokuroria nuk duhet ta
22 ndiqte këtë dëshmitar sipas rregullës 154, por të bëhej
23 dëshmia *viva voce*. Po nuk mund të pretendojnë që ne ta kishim
24 këtë seancë sipas rregullës 154 për vërtetësinë e përmbajtjen
25 dhe më pas të bëjnë diskreditim të deklaratave.

1 Z. EMMERSON: [Përkthim] A më dëgjoni?

2 Meqë tani kaluam tek kjo tema që unë po ashtu doja ta
3 trajtoja. Ju lutem do të doja që të fokusohemi te paragrafi 5
4 i Shënimit Përgatitor numër 1 të këtij dëshmitari. Numrin e
5 provës materiale P1137. Nëse e keni gati është diku nga mesi e
6 poshtë në paragraf, dy e treta. Edhe këtu thuhet:

7 "Pace vuri re, vërejti se Dëshmitari 3865 duket se po jep
8 informata që janë në mospërputhje me deklaratat e tij të
9 mëparshme, veçanërisht sa i takon Sadik Halitjahës. Kur iu
10 lexuan materialet, dëshmitari ka thënë se çdoherë që ai dhe të
11 tjerët përmendin Sadik Halitjahën kanë dashur t'i referohen
12 shtabit të batalionit. Pra, Sadik Halitjaha ishte si simbol
13 për shtabin dhe padyshim që ai ka qenë komandant batalioni
14 ..."

15 Tani ka pasur komunikime mes nesh dhe e i kemi kërkuar z.
16 Pace ta tërhiqte këtë paragraf në një deklaratë që ai donte ta
17 paraqiste si provë. Sepse ka paraqitur opinionin e tij dhe
18 dëshmitari i ka dhënë z. Pace të njëjtën përgjigje si dhe sot.
19 Pyetja përsëritet e përsëritet, z. Pace e kupton shumë mirë
20 përgjigjen. Ka kërkuar që të pranohet deklarata e dëshmitarit
21 ndonëse ka bërë komente krejt të papërshtatshme në këtë
22 material dhe sikur kundërshtimi i z. Misetic, edhe
23 kundërshtimi im -- pra kundërshtimi paraparak pra për rregullën
24 154 apo nëse duhet bërë ndonjë udhëzim për Prokurorinë tani që
25 të mos i bëjë më pyetjet që i ka bërë gjatë seancës

1 përgatitore të përsërisë pyetjet dhe përgjigjet. Dhe të
2 kalojmë në një pjesë që konsiderohet diskreditim i deklaratave
3 të dëshmitari për arsye krejt teatrale.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

5 Z. PACE: [Përkthim] Fillimisht unë do të doja të thoja që
6 këto komente duhet t'i kishim bërë jo në praninë e
7 dëshmitarit, gjithashtu nuk i pranoj komentet e z. Emmerson.
8 Unë po bëj punën time në mënyrë krejt të drejtë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

10 Z. PACE: [Përkthim] Po unë do ta trajtoj sigurisht këtë
11 aspekt, po unë nuk i pranoj këto lloj komente që unë nuk jam
12 sjellë në mënyrë të përshtatshme.

13 Dëshmitari e ka konfirmuar deklaratën sipas rregullës
14 154, është paraqitur si provë bashkë me sqarimet që ka bërë
15 dëshmitari, prandaj të nderuar Gjykatës, përpara jush keni të
16 gjithë informacionin përkatës. Unë po bëj punën time nëse ju
17 gjykoni që unë po bëj pyetje të papërshtatshme atëherë mund të
18 më bëni pyetje. Unë thjesht dua të sqaroj pse në një moment ka
19 dhënë një përgjigje dëshmitari dhe tani po jep një përgjigje
20 tjetër.

21 Ne duam të zbulojmë të vërtetën e cila është e vërteta.
22 Dhe ky është i vetmi arsye për ndryshimin përkatës.

23 Dhe përveç kësaj vendimin e merr Trupi Gjykses edhe është
24 marrë një vendim në materialin F02117, paragraf 15, ku
25 përcaktohet qartë se çfarë duhet të bëjmë e të mos bëjmë ne

1 edhe në rastet kur Prokuroria beson se dëshmitari po ndryshon
2 apo tjetëron pjesë të caktuara të dëshmisë.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shiko,
4 pyetjen e keni bërë disa herë. E keni marrë përgjigjen. Unë po
5 them që ju thjesht nuk u pëlqen përgjigja tani. kështu që më
6 mirë vazhdoni dhe bëni pyetjet e tjera.

7 Z. PACE: [Përkthim] Do të doja të bëja një parashtrimin,
8 të nderuar Gjykatës, por jo në praninë e dëshmitarit.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë
10 dëshmitari do të duhet të dalë nga salla.

11 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni z.
13 Pace.

14 Z. PACE: [Përkthim] Do të doja të thoja që doja t'ju
15 pyesja ju paraprakisht po me sa kam unë dijeni dëshmitari nuk
16 e ka mohuar që e ka thënë disa herë faktin që i ka propozuar
17 Sadik Halitjahës këtë gjë.

18 Dhe unë i thashë atij që e keni bërë katër herë. Unë doja
19 që t'i tregoja të katërta rastet për ta ndihmuar me kujtesën
20 ose mbase ai ka ndonjë shpjegim se çfarë ka dashur të thotë
21 kur i tregojmë ne se çfarë ka në tekst.

22 Jam në duart tuaja. Nëse ju mendoni që kjo nuk është e
23 dobishme atëherë unë tërhiqem. Vendorsni ju në qoftë se kjo
24 procedurë është e përshtatshme apo e papërshtatshme

25 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk duhet të
2 bërë -- nuk duhen bërë edhe një herë pyetjet. Tashmë u
3 vërtetua se ai ka mospërputhje me deklaratat e tij të
4 mëparshme. Ju mund ta pyesni dëshmitarin që të shpjegojë pse
5 ka tashmë një dallim dëshmive, por nuk do të hyni një për një
6 në të gjithat materialet siç thashë pak më përpara.

7 Z. PACE: [Përkthim] Në rregull, të nderuar Gjykatës.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ky është
9 vendimi përfundimtar i Trupit Gjykses. Dëshmitari mund të vijë
10 sërish në sallë.

11 [Dëshmitari vijon dëshminë]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, z.
13 Pace ka edhe disa pyetje të tjera por ka një pyetje konkrete
14 lidhur me atë që sapo dëshmuat një çast më përpara.

15 Z. PACE: [Përkthim]

16 PY. Dëshmitar, pyetja ime është kjo: A doni të na shpjegoni
17 pse në deklaratën që keni dhënë për UNMIK-un dhe për ZPS-në ju
18 keni thënë që propozimin për transferimin ose lirimin e Latife
19 ose -- dhe Rushe Kolollit ja keni bërë Sadik Halitjahës,
20 ndërsa sot po thoni që propozimin ja keni bërë Naim Kadollit
21 dhe Agim Zybës.

22 Ju lutem, a mund t'ja shpjegoni Trupit Gjykses pse e
23 thoni ndryshe sot arsyen për këtë dallim?

24 PË. Unë e thashë edhe më parë që çdo gjë që është lidh me
25 batalionin e Budakovës, është personifiku shtabi dhe Sadik

1 Halitjaha. Për atë edhe e kam thënë, përndryshe unë ka pas
2 javë që s'jemi pa me Sadik Halitjahën se ai ka pas detyrat e
3 veta qoftë ushtarake qoftë politike. Unë s'jam kon në atë
4 nivel të atyne për dhon urdhra kërrkuj as për me bisedu për
5 çështje të këtij niveli me dikënd prej atyne. Kështu që unë
6 kam bisedu me Agimin edhe me Naimin. Ata tani me kënd kanë
7 bisedu, nuk e di. Atyne ju kam thënë që nuk ka elemente për
8 këto dy persona kështu që ata duhen të lirohen. Unë e thashë
9 edhe më herët. Kjo është përgjigja q'kjo.

10 PY. Dëshmitar, gjatë intervistës me ZPS-në se ju thatë që nuk
11 e kisha unë kompetencë të merrja vendimin për lirimin e
12 Latifes dhe Rushe Kolollit. A ju kujtohet që e thatë këtë?

13 PË. Veç propozim kam bo unë. Kam propozuar, s'kam vendos. Unë
14 nuk kam mujt me vendos as atëherë as tash.

15 PY. Dëshmitar, a ju kujtohet që gjatë intervistës me ZPS-në
16 ju thatë se i vetmi person që mund të merrte vendim për
17 lirimin e transferimin e këtyre dy grave në brigadë ishte
18 Sadik Halitjaha?

19 PË. Unë mendoj se shtabi i brigadës ka qenë aty.

20 PY. Dëshmitar, nuk iu përgjigjët tamam pyetjes sime. Pyetja
21 ime ishte kjo: A ju kujtohet që gjatë intervistës me ZPS-në
22 keni thënë se këtë vendim mund ta marrë vetëm Sadik Halitjaha.
23 A ju kujtohet që e keni thënë këtë?

24 PË. Nuk më kujtohet që kam thënë vetëm veç Sadik Halitjaha po
25 mund ta merr shtabi, normalisht në kry me Sadik Halitjahën.

1 PY. Dëshmitar, në deklaratat e mëhershme keni thënë që kur
2 keni qenë anëtar i UÇK-së në Budakovë, keni biseduar me Latife
3 Kulollin dhe i keni bërë pyetje, dhe Rushe Kulollit edhe një
4 burri shqiptar. Dhe një më përpara keni folur edhe me një serb
5 që ishte në Budakovë me një person tjetër që dukej se ishte në
6 moshë të mitur. Po ashtu keni thënë se keni biseduar me një
7 burrë në Volljakë --

8 PËRKTHYESJA: Përkthyesi kërkon ndjesë, nuk e ka kuptuar
9 emrin e fshatit.

10 Z. PACE: [Përkthim]

11 PY. -- gjatë kësaj bisede mund të kenë qenë të pranishëm edhe
12 Nazmi Kofolli [Sipas përkthimit].

13 Tani unë desha t'ju pyes nëse e keni biseduar ndonjëherë,
14 a ju ka pyetur anëtar i UÇK-së ndonjëherë çfarë biseduat me
15 këta persona. Çfarë bisedash patët me këta?

16 PË. Nuk po di kush është ai Nazmi Kodolli -- s'e kam të
17 kjartë edhe është e vërtetë se me atë serbin, sikur që kemi
18 deklaruar edhe para një jave bash me juve unë nuk jam kon kur
19 ata i kanë sjellë, [E pakuptueshme] i kanë legjitimue me
20 rastin e hyrjes në zonën e luftës q' ai serbi emrin që s'ja di,
21 sigurisht e ka të shkruar aty ka qenë me një fëmi të vogël të
22 mitur, për afërsisht sipas meje 12, 13 vjeçar, ai ka qenë i
23 armatosur me një çifte, lovaçkë si i thojnë, dhe një armë
24 zjarri e ka pas një revole që mbushet nga gryka, s' di a ju
25 kujtohet *kobure i thojnë te na. Edhe kur kam dëgju --*

1 PY. Dëshmitar, do t'ju ndërpres sepse po përsërit çfarë e
2 kemi në fakt në deklaratën tuaj. Do ta bëj edhe një herë
3 pyetjen. Ishte pyetje e gjatë dhe ndoshta ishte faji im,
4 kështu që do ta marr hap pas hapi që ta kuptoni drejtë.

5 Sa ju takon këtyre dy serbëve për të cilët po flisnim,
6 pyetja ime konkrete është kjo: A ka pasur anëtarë të UÇK-së që
7 kanë folur me ju apo që ju kanë marrë ju në pyetje lidhur me
8 atë çfarë ju ka ndodhur këtyre dy serbëve?

9 PË. Kanë -- s'ka pas kush që më pyt se ajo ka qenë publik, në
10 vend publik, në qendër të Budakovës janë sjellë ata. Kanë
11 bisedue të gjithë. Kur kam shku unë veç a kon puna e kryne. Ka
12 bisedu Isë Morina me ta, edhe i kanë thirr OSBE-në. OSBE-ja i
13 ka marrë. Q'kaq ka pas. As ka qenë [E pakuptueshme] kanë qenë
14 të legjitimum edhe ka përfundunu kjo çështje. I ka marrë OSBE-
15 ja dhe ma s'dimë gjë për ta.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace,
17 duhet t'i japim një pushim 10 minuta dëshmitarit, z. Pace.

18 Dëshmitar, do të bëjmë pushim për 10 minuta. Ju lutem
19 dilni nga salla i shoqëruar nga Asistentja. Do të kthehemi për
20 10 minuta.

21 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, dëshiroj që të
23 them diçka për procesverbal përpara se të fillojmë me
24 kundërpyetjet. Prokurori iu referua parashtrimin tuaj të
25 protokolluar me numrin F02117 në paragrafin 15 lidhur me një

1 çështje etike që e ngrita unë.

2 Ne pajtohemi me konstatimet e Gjykatës, çfarë do të thotë
3 që Prokuroria mund ta bëjë këtë gjë vetëm në qoftë se e bën të
4 qartë që nuk dëshiron që të mbështetet në një ose më tepër
5 prej këtyre pikave, jo për vërtetësinë e përmbajtjes por për
6 besueshmërinë. Çfarë do të thotë që nga Prokuroria pra në
7 qoftë se Prokuroria duhet ta sqarojë pra në qoftë se
8 deklaratat e 154 i përdor vetëm për përmbajtjen apo vetëm në
9 qoftë se ka të bëjë besueshmërinë. Pra duhet të na e sqarojë
10 Prokuroria këtë gjë.

11 Z. PACE: [Përkthim] Nuk e kuptova çfarë tha avokati. Nuk
12 dëgjoja asgjë se çfarë na detyron neve që të themi tani ose ku
13 të mbështeteni tani. Ne jemi këtu për të eksploduar më tepër
14 dëshminë e dëshmitarit kështu që mbështetur në atë çfarë do të
15 thotë më përpara nesh dhe Gjykatësit dhe dëshmitë e tjera do
16 të bëjmë parashtrime përkatëse përfundimtare tonat sot ose
17 nesër.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, Mbrojtja ka të
19 drejtë që të dijë se çfarë qëndrimi ka Prokuroria sa i takon
20 këtij dëshmitar sepse ato sapo kërkuan pranimin e dëshmisë
21 sipas deklaratës së rregullës 154. Por në nenin 14 të Kodit të
22 Sjelljes Profesionale i takon që parashtrimi sipas Prokurorisë
23 është i rremë. Kështu që duam ta dimë që ku qëndron Prokuroria
24 lidhur me këtë. Domethënë duam që ta dimë që Prokuroria për
25 shembull mbështetet te rregulla 154 për vërtetësinë e dëshmisë

1 dhe që po marrim në pyetje dëshmitarin sa i takon pikave të
2 tjera të mbështetshmërisë. Është e rëndësishme për neve që ta
3 sqarojë këtë gjë Prokuroria.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E mbajmën
5 shënim do ta trajtojmë më vonë.

6 Bëjmë dhjetë minuta pushim edhe do të mblidhemi përsëri
7 këtu në orën katër pa një çerek.

8 --- Pauza fillon në orën 15.35

9 --- Seanca rifillon në orën 15.46

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Asistente, ju
11 lutem silleni dëshmitarin në sallë.

12 [Dëshmitari vijon dëshminë]

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace, sa i
14 takon kundërshtimit të mëparshëm, ne besojmë që ju duhet ta
15 sqaroni mirë qëndrimin tuaj sa i takon këtij informacioni.
16 Domethënë, informacioni po ofrohet për të kundërshtuar
17 besueshmërinë ose për të sulmuar besueshmërinë apo ka të bëjë
18 me vërtetësinë e dëshmisë së dhënë. Duhet të jetë ose njëra
19 ose tjetra kështu që duhet ta bëni të qartë pozicionin tuaj z.
20 Pace.

21 Z. PACE: [Përkthim] Në qoftë se do të më lejoni një
22 sekondë që të konsultohem me kolegët.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Nuk ka përkthim]

24 [Anëtarët e Prokurorisë këshillohen]

25 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

1 Besoj se mënyra se si e kemi bërë, se si jemi sjellë e kemi
2 bërë të qartë që ne besojmë versionin origjinal që ka dhënë
3 dëshmitari dhe atë çfarë i ka thënë dëshmitari në deklaratë
4 UNMIK-ut. Dhe tani ne po mundohemi që t'i marrim dëshmitarit
5 sepse ka ndryshuar pozicionin e thënë më përpara.

6 Për t'ju përgjigjur pyetjes tuaj versioni ku ne
7 mbështetemi është versioni që dëshmitari ka dhënë sipas
8 deklaratës 154 ndërkohë që detyrimet tona duke ofruar
9 versionet e mëpasshme të versioneve të ndryshme të
10 dëshmitarit, sipas Shënimit Përgatitor numër 1, vërtetojnë
11 këtë lloj versioni tonin të dëshmitarit.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Kundërshtoj parashtrimin e dhënë
14 sepse deklarata 154 ka të bëjë me versionin e korrigjuar, apo
15 jo? Domethënë, sipas urdhrit të dhënë nga Trupi Gjykses 154
16 merr të ka të bëjë dhe nga ana tjetër të paktën ekziston
17 përpjekja për diskreditim të një deklaratë në krahasim të
18 paktën me një deklaratë të me përparshme dhe ne parashtrojmë
19 që kjo në fakt ka të bëjë me nenin 14(3) të Kodit të Sjelljes
20 sepse në të kundërtën do të kishim probleme me vërtetësinë e
21 përmbajtjes.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Çfarë po
23 kërkoni se nuk ju kuptoj.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Po kërkojmë që ose të përjashtohet
25 mbështetshmëria tek versioni jo i korrigjuar sipas deklaratës

1 154 ose të tërhiqet pranimi sipas rregullës 154 dhe të
2 vazhdohet viva voce me këtë dëshmitar. Ose njëra ose tjetra.

3 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të na
4 jepet pak baza, parashtrimi ligjor për këto propozime sepse
5 kjo nuk është hera e parë kur një dëshmitar thotë diçka sipas
6 dëshmisë së rregullës 154 dhe pastaj e sqaroj ose e ndryshon
7 këtë gjë siç ka ndodhur në Shënimin Përgatitor.

8 Gjëja e rëndësishme këtu, të nderuar Gjykatës, është që
9 informacioni i është dhënë Mbrojtjes. Juve na pyetët ndërkohë
10 që unë ju dhashë përgjigjes që bëtë ju, të nderuar anëtarë të
11 Trupit Gjykues, kështu që nuk e di se çfarë problemi shkakton
12 kjo për Mbrojtjen apo çfarë problemi mund të kenë ekipet e
13 Mbrojtjes për të bërë pyetje për dëshmitarin ndërkohë që
14 akuzat janë të qarta dhe qëndrimi ynë është i qartë. Pra të
15 gjithë dokumentet janë të disponueshme si për Trupin Gjykues
16 ashtu dhe për palët.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se më lejoni, a mund të
18 vazhdoj? Siç e thashë baza jonë është neni 14(3) i Kodit të
19 Sjelljes Profesionale, por jo vetëm kaq por edhe në parashtrim
20 vetë Prokuroria thotë në F02117, në paragraf 15, bëhet e qartë
21 që jo, nuk mund ta bëni këtë gjë sa i takon vërtetësisë së
22 përmbajtjes së saj. Dhe këtë gjë ZPS-ja e di shumë mirë.

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk e di në qoftë se mund të
24 shtoj unë edhe diçka lidhur me këtë. Kemi pasur korrespondencë
25 të vazhdueshme me z. Pace për disa ditë, lidhur me këtë pjesë

1 të Shënimit Përgatitor 2 ku ai shpreh mendimin e vet lidhur me
2 pozicionin ose qëndrimin dhe përgjigjen që rrjedh nga 154 që
3 ka bërë me ofrimin e dëshmive për vërtetësinë e dëshmitari, e
4 dëshmive të dhëna.

5 Ndërkohë që jemi në një situatë të tillë ku ne në fakt e
6 kemi pyetur, kemi kërkuar që Prokuroria të mund të ta bërë të
7 qartë qëndrimin e vet më herët.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ju
9 dëgjova.

10 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po ju them që kemi qenë -- kemi
11 ditë që jemi në korrespondencë me Prokurorinë. Kam kërkuar
12 disa më përpara që të redaktohet kjo pjesë megjithatë kjo
13 kërkesë e imja është kundërshtuar.

14 Z. PACE: [Përkthim] Në qoftë se më lejoni shkurtimisht,
15 të nderuar Gjykatës.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]
17 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta
19 shtjellojmë sugjerimin e z. Emmerson lidhur me redaktimet dhe
20 do të marrim një vendim sa më shpejt që të mundemi. Tani do të
21 vazhdojmë më tej.

22 Z. Pace, dëshmitari i fundit është një shembull i mirë
23 asaj çfarë ndodh se kur keni informacion kontradiktor kështu
24 që do të kishte qenë më mirë që këtë dëshmitar mund ta kishe
25 thirrur dëshmitar *viva voce*. Është shumë e vështirë që të

1 kalojmë këtë lloj situatë sipas rregull 154. Është e vështirë
2 edhe për ta shpjeguar e jo më që ta përdorim rregullën 154 në
3 këtë rast.

4 Duke ta keni parasysh këtë rast në të ardhmen ndërkohë që
5 tani për momentin le të vazhdojmë më tej.

6 Kështu që do të ishte më mirë besoj që është e qartë për
7 të gjitha palët se cila është qëndrimi i Prokurorisë dhe cila
8 është situata, kështu që besoj që jemi në rregull që të po të
9 vazhdojmë.

10 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, Kryegjykatës.

11 PY. Dëshmitar, në deklaratë të mëparshme keni thënë që kur
12 keni qenë anëtar i UÇK-së në Budakovë keni pasur biseda ose
13 keni bërë pyetje për Latife Kolollin, Rushe Kolollin edhe një
14 burri tjetër shqiptar rreth të njëjtës kohë, pak a shumë.

15 Pyetja ime për ju është kjo, a ka folur ndonjë anëtar i UÇK-së
16 apo të ka pyetur ndonjëherë ndonjë anëtar i UÇK-së lidhur me
17 atë çfarë ju ka ngjarë apo çfarë ju ka ndodhur këtyre tre
18 personave që i përmenda pak më herët?

19 PË. Po, kanë pyetur çka ndodhi me ta. Kam thënë që ata nuk
20 kanë asgjë të fajshme dhe kam propozuar që të lirohen.

21 PY. Pra, në përgjigjen tuaj ju thoni që njerëzit më pyetën se
22 çfarë ju ndodhi atyre. Këto persona të cilët ju pyetën se
23 çfarë ju kishte ndodhur Latife Kolollit, Rushe Kulollit edhe
24 këtij burrit shqiptar a ishin anëtarë të UÇK-së këta që ju
25 pyetën apo jo?

1 PË. Ushtarë të UÇK-së. Ushtarë.

2 PY. A ju kujtohen emrat e ndonjë ushtari që ju ka pyetur se
3 çfarë ju ka ndodhur këtyre tre personave që i përmenda pak më
4 herët?

5 PË. As që më ka interesu me i majt mend. Ushtarë të thjesht
6 sikur që kemi qenë edhe na.

7 PY. A e kuptoj drejtë që kjo do të thotë që askush nga stafi
8 i batalionit, shtabi i batalionit, nuk ju ka bërë pyetje
9 lidhur me çfarë ju ka ndodhur këtyre tre personave? Domethënë
10 s'ka qenë askush nga batalioni që ju ka bërë pyetje me fjalë
11 të tjera?

12 PË. Thashë po, por nuk më kujtohet kush ka bërë shumë pyetje
13 të cilat meritojnë me koment.

14 PY. Dëshmitar, po kërkoj që të më bëri ca sqarime sepse ju
15 thashë [Sipas përkthimit] që ishin ushtarë të zakonshëm,
16 personat që ju kanë pyetur. Kur thua që kanë qenë ushtarë të
17 zakonshëm, si ta kuptoj që nuk kanë qenë pjesë e shtabit të
18 batalionit ku ke qenë pjesë ti, apo ta kuptoj ndryshe?

19 PË. Pjesëtarë të batalionit jemi kanë të gjithë, 750 ushtarë
20 kanë qenë aty.

21 PY. Sadik Halitjaha ka qenë komandant i batalionit, kështu?

22 PË. Patjetër.

23 PY. Sa pjesëtarë të tjerë të shtabit të batalionit që kanë
24 qenë përgjegjës për batalionin sa kanë qenë, domethënë kanë
25 qenë 150 veta apo më shumë anëtarë të batalionit, sa kanë

1 qenë, 150 veta apo më shumë?

2 PË. S'po kuptoj pyetjen, anëtarë të batalionit a ushtarë?

3 PY. Dëshmitar, ju keni qenë ushtar në batalionin e Budakovës,
4 apo jo? Nuk keni qenë anëtar i shtabit të Budakovës po keni
5 qenë thjesht ushtar. A është e saktë kjo?

6 PË. Patjetër.

7 PY. Tani, a ka pas ndonjë person që ka qenë pjesëtar i
8 shtabit të batalionit që ju ka pyetur juve se çfarë i ka
9 ndodhur Latife Kolollit, Rushe Kolollit ose këtij burrit
10 shqiptar që ka qenë i ndaluar në të njëjtën periudhë?

11 PË. Jo, nuk kam pas kontakte me ta.

12 PY. A ka pas ndonjë person brenda shtabit që ju pyetur se
13 çfarë ju ka ndodhur këtyre personave në -- sepse ju keni thënë
14 që keni pasur një bisedë në Volljakë në praninë e Ilaz
15 Kadollit?

16 PË. Çfarë persona? S'po e kuptoj pyetjen përsëri.

17 PY. Në deklaratën që keni dhënë ju na keni thënë që keni
18 pasur një bisedë ose intervistë me një person që thonin që kjo
19 biseda ka ndodhur në Volljakë ku ka qenë i pranishëm edhe Ilaz
20 Kadolli. A ju kujtohet kjo?

21 PË. Po. Po.

22 PY. Tani, lidhur me këtë rast, me këtë bisedë a të ka pyetur
23 ndonjë person nga shtabi i batalionit ose nga zona e
24 Pashtrikut që të ka pyetur ty se çfarë ka ndodhur me këta
25 persona?

1 PË. Po kanë pyetur se çka, çfarë ka ndodh se këtu ka qenë një
2 problem siç e thashë edhe më herët rreth do ushqimeve që janë
3 sjellë nga Fondi Nëna Terezë dhe ato kanë mendu se janë tuj u
4 keqpërdor, nuk janë tuj u nda në mënyrë të barabartë në
5 popullatë se popullata ka qenë krejt e zhvendosur dhe ka pasur
6 nevojë për ushqime me i dhënë prej ushtrisë. Kështu që personi
7 që e përmendët kanë mendu që nuk i ka bo ndarjen e drejtë dhe
8 për atë është akuzu. Po mendoj është përmend këtu, në këtë
9 rast, e kemi bashkëbisedu na me Ilaz Kadollin.

10 PY. Dëshmitar, pasi patët këtë bisedën që sapo e përshkruat a
11 ju pyeti ndonjë pjesëtar i UÇK-së "Dëshmitar, z. Abazi, çfarë
12 i ka ndodh këtyre personave që i keni", a ja u ka thënë, a jua
13 ka bërë këtë pyetje ndokush brenda UÇK-së? Ju ka pyetur njeri
14 brenda UÇK-së lidhur me këtë, Dëshmitar?

15 PË. Po kanë pyetur po s'kanë dit ata se kjo ka kon jashtë
16 Budakovës. A kone larg. S'kanë mujt me e dit të gjithë. Shumë
17 pak kush e ka dit. Volljaka me Budakovë është -- Volljaka
18 është dikun 50 kilometra, më shumë.

19 PY. A ju kujtohet se kush nga UÇK-ja ju ka pyetur se çfarë ka
20 ndodhur për këta personat për të cilët po flasim?

21 PË. S'po di çka është me rëndësi kjo.

22 PY. A mund t'i thoni Gjykatësit se si e ka pas emri personi
23 ose personat që ju kanë pyetur se çfarë ka ndodhur me këta
24 persona për të cilët po flasim?

25 PË. Sa më kujtohet -- veç ma ja u përmend ndonjë emër kështu

1 pa lidhje, as që i kam majt mend.

2 Z. PACE: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

4 Z. Misetic, fjala për ju.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi Smith.

6 Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic:

7 Z. MISETIC: [Përkthim]

8 PY. Dëshmitar, mirëdita. Unë quhem Luka Misetic. Jam avokati
9 për Hashim Thaçin.

10 PË. Mirëdita.

11 PY. Do t'i bëj disa pyetje, së pari do t'ju pyes lidhur me
12 strukturën dhe organizimin e UÇK-së. A është e saktë se ju
13 jeni kyçur në UÇK në qershor 1998?

14 PË. Po, zotëri avokat.

15 PY. Rreth kohës kur vendosët që të kyçeshit në UÇK,
16 shqiptarët kishin filluar që të mblidheshin me njëri-tjetrin
17 në përgjigje të zhvillimeve të fundit si për shembull vrasjen
18 e familjes Hashari [Sipas përkthimit] dhe të mësuesit në
19 Llaushë; a është e saktë kjo, Dëshmitar?

20 PË. Patjetër.

21 PY. A është e saktë, sikur ju thoni në dëshminë tuaj se ishte
22 ndikimi i këtyre ngjarjeve që ju bëri juve që të merrnit
23 vendimin që të kyçeshit në UÇK?

24 PË. Këto ngjarje edhe të mëhershmet shumë. Jo vetëm këto.

25 PY. Çfarë ngjarjesh të mëhershme?

1 PË. Ka pas demonstrata, ka pas vrasje, ka pas vrasje të
2 ushtarëve, ka pas masakra edhe para se me fillu lufta. Ka pas
3 keqtrajttime, ka pas burgosje. Çdo gjë e zezë është bë në
4 popullin tonë prej një shteti barbar, pushtues, pa skrupuj.

5 PY. Në rregull. Si rezultat ju vendosët që të shkonit dhe të
6 kërkonit dhe të shikonit në qoftë se kishte ndonjë lloj
7 organizimi të UÇK-së në fshatin tuaj. Kështu ka qenë fillimi?

8 PË. Po.

9 PY. Dhe morët vesh që një bashkëfshatar tjetër me emrin Sadik
10 Halitjaha kishte filluar që të mblidhte njerëzit në fshatin
11 tuaj. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

12 PË. Sadik Halitjaha ka ardhë prej Zvicrës ka pas organizime
13 edhe të më hershme po edhe këto të luftës. Normalisht që ka
14 organizu.

15 PY. Po, por ai po e organizonte fshatin tuaj për të formuar
16 një formacion një njësit të UÇK-së aty. A është e saktë kjo,
17 Dëshmitar?

18 PË. E saktë.

19 PY. Pra, në qershor 1998 a është e saktë që mesa dini ju UÇK-
20 ja ishte një organizim në nivel lokal të bashkëfshatarëve që
21 po përpiqeshin që të organizoheshin?

22 PË. Po, ka qenë organizim masiv, jo vetëm në kuadër të
23 fshatit tim. Masiv ka qenë në krejt Kosovën gati.

24 PY. Në rregull. Dhe nuk kishte ndonjë proces zyrtar të kyçjes
25 në UÇK apo jo?

1 PË. Jo, zotëri avokat, kjo ka qenë krejt vullnetare. E vetmja
2 ushtri në botë që ka qenë vullnetare. Nuk ka mujt askush
3 kërrkënd me detyru me shku ushtar vetëm ai që e ka ndi veten
4 që ka nevojë me i dalë zot vendit, ai është kyç. Ai që s'e ka
5 marrë të arsyeshme ai nuk është kyç, s'ka mujt askush me dhunë
6 me e çue në ushtri. Krejt është organizu në baza vullnetare.

7 PY. Në rregull. Kur njerëzit kyçeshin në UÇK-së atyre ju
8 duhej që t'i blenin vetë me lekët e veta uniformat edhe armët,
9 apo jo, Dëshmitar?

10 PË. Shumica.

11 PY. I keni thënë ZPS-së se uniformat që vishnin njerëzit
12 ishin uniforma të ushtrisë gjermane dhe uniforma amerikane. A
13 është saktë kjo, Dëshmitar?

14 PË. Shumë e saktë.

15 PY. Ju thoni që kishte gjithashtu edhe civilë që nuk kishin
16 uniformë, kështu?

17 PË. E vërtetë.

18 PY. Kur e keni thënë këtë, a doni -- keni dashtë të thoni që
19 kishte anëtarë të UÇK-së që nuk kishin uniformë, apo e kishit
20 fjalën për civilë që nuk ishin të kyçur në UÇK dhe nuk ishin
21 pjesë e UÇK-së?

22 PË. Ushtarë të UÇK-së të cilët nuk kanë pasur uniforma, nuk
23 kanë pas as armë. Ne e kemi prit një armë derisa të vritet një
24 ushtar me ja marrë armën. Dhe asi rasti ka pas. Dy-tre vetë
25 kanë qenë me një armë të organizim. Kur u kyçet në UÇK a

1 nënshkruat ndonjë dokument apo a morët ndonjë vendim që
2 thoshte që ju jeni emëruar në një post të caktuar?
3 PË. Po, kemi shkru në fillim. Kemi shku jemi nënshkru ka qenë
4 ditat i punës, një ditat i kyçjes në UÇK dhe e kemi nënshkru
5 të gjithë.

6 PY. Në dëshminë tuaj keni thënë që ju ishit këshilltari
7 juridik. Ky ishte emërim me shkrim, domethënë thjeshtë ja u
8 kanë thënë me gojë apo ju kanë dhënë një dokument ku ju kanë
9 caktuar si këshilltari juridik.

10 PË. Ka pas me shkrim po nuk e di ku është se ka pas me
11 shkrim, një vendim me shkrim që këshilltar ligjore, juridik,
12 ligjor. Po tani janë kallë të gjitha dokumentat edhe na kanë
13 kallë edhe shpiat edhe na kanë kallë edhe njerëzit në shtëpia.
14 Ka qenë tmerr.

15 PY. Kush ju ka emëruar juve në atë pozicion? Kush e ka
16 nënshkruar emërimin tuaj si këshilltar juridik?

17 PË. Sadik Halitjaha.

18 PY. A ju kujtohet se kur e ka nënshkru këtë dokument ai?

19 PË. Po q'atëherë kur jemi organizu, kur kemi dalë në luftë
20 kur jemi kyç. Pak ma vonë dikun nja dy-tre muaj.

21 PY. Pra, në qoftë se jeni kyçur në qershor, i takon që dy-tre
22 muaj më vonë duhet të ketë qenë nga shtatori ose nga tetori,
23 kështu? Gushti ose shtatori, kështu?

24 PË. Në shtator ka qenë ofensiva kryesore ku kemi qenë të
25 shkatërrim totalisht.

1 PY. Çfarë detyrash keni pasur ju në funksionin si këshilltar
2 juridik?

3 PË. Detyrat e mia kanë qenë me i këshillu ushtarët si me u
4 sjellë mes vedit, si me u sjellë me civilët, mos me bo gabime.
5 Q'ato janë kone detyrat e mia.

6 PY. A ju kujtohet se çfarë këshillimesh konkrete ju keni
7 dhënë ushtarëve sa i takon marrëdhënieve me civilët? Çfarë ju
8 keni thënë konkretisht?

9 PË. Marrëdhënien ndërnjerëzore qysh duhet me u sjellë një
10 ushtar, çka i ka hije një ushtari, mos me pi alkool, mos me
11 dalë pa leje, mos me ba gjëna të këqija. Qëto janë kanë, s'ka
12 pas të tjera.

13 PY. Ju vetë keni shërbyer në ushtrinë jugosllave, apo jo? E
14 keni kryer shërbimin ushtarak në ushtrinë jugosllave, kështu?

15 PË. Po.

16 PY. Ky ka qenë shërbimi i detyrueshëm ushtarak me ushtrinë
17 jugosllave?

18 PË. I detyrueshëm.

19 PË. Sa i takon ushtarëve të tjerë, po ata a ishin trajnuar, a
20 kishin marrë trajnim të detyrueshëm përveç ushtrisë jugosllave
21 që kishin bërë?

22 PË. Jo, zoti avokat, s'ka pas. Ata jonë kon kryesisht të
23 rinj. Ushtria jonë ka qenë e re që nuk e kanë pas shërbimin
24 ushtarak të krymë. Pak kemi kone na, pak të moshës më të madhe
25 që kemi pas shërbimin ushtarak të krymë. Ndërsa ushtarë të

1 tjerë kanë qenë prej 18 vjetëve e përpjetë. Se kohët e fundit
2 ne e kemi bojkotu shërbimin ushtarak jugosllav, se [E
3 pakuptueshme] prej ushtrisë nëpër sa ne jke të vdekur. Për atë
4 na e kemi kundërshtu edhe e kemi bojkotu ushtrinë. Kështu që
5 ushtarët çka kanë qenë kryesisht në UÇK kanë qenë pa përvojë,
6 të rinj që kurrë s'kanë pas armë në dorë. Për herë të parë
7 kanë dalë.

8 PY. Në rregull. Pjesa më e madhe këtyre të rinjve nuk është
9 se janë trajnuar kur u kyçën në UÇK apo jo, Dëshmitar?

10 PË. Po, ashtu është.

11 PY. Kur jeni kyçur në qershor 1998, a është e saktë se
12 batalioni në Budakovë ishte ende në organizim e sipër?

13 PË. Po gjithsesi.

14 PY. Me aq sa dini ju, ky ishte batalioni i parë në atë zonë,
15 apo jo?

16 PY. Po, zoti avokat.

17 PY. Duke marrë parasysh madhësinë e këtij batalioni dhe
18 faktin që ju po ishit në organizim e sipër, a është e saktë
19 siç thoni ju në dëshminë tuaj që nuk mund të kishte biseda për
20 një brigadë ose për një strukturë më të madhe në atë kohë?

21 PË. Po ndërkohë janë formu edhe brigadat, dhe brigadat janë
22 formu, por batalioni -- brigadat kanë qenë në Suharekë, ka
23 qenë brigada jonë. Që është formuar gati se paralelisht.

24 PY. A ka pasur një brigadë në kohën kur jeni kyçur juve në
25 qershor 1998, apo ka pas vetëm batalion në atë kohë?

- 1 PË. Po më duket ne ma së pari kemi don me [E pakuptueshme].
- 2 Qysh e di unë. Krejt po flas prej botëkuptimit tim.
- 3 PY. A ju kujtohet se sa kohë kaloi nga momenti kur u kyçët ju
- 4 në UÇK deri kur u krijua brigada?
- 5 PË. Një muaj q'ishtu. Përafërsisht, sipas mendimit tem.
- 6 PY. Domethënë i takon diku nga korriku ose gushti, kështu?
- 7 PË. Ashtu diçka.
- 8 PY. Tani, le të kalojmë në rolin tuaj si këshilltar juridik.
- 9 Ju fillimisht e keni nisur punën si ushtar i zakonshëm,
- 10 kështu?
- 11 PË. Po.
- 12 PY. Roli juaj si këshilltar juridik ishte vetëm batalionin
- 13 tuaj në Budakovë apo shtrihej dhe më tej, përtej këtij
- 14 batalioni?
- 15 PË. Vetëm për batalionin.
- 16 PY. Në kohën kur u kyçët në UÇK juve kishit përfunduar
- 17 fakultetin juridik nga Universiteti i Prishtinës, apo jo,
- 18 Dëshmitar?
- 19 PË. Fakultetin e kam përfundu në vitin 1980. 1980.
- 20 PY. Në rregull. Ju nuk është se keni praktikuar juridikun
- 21 përpara sesa të kyçeshit në UÇK apo jo?
- 22 PË. Jo.
- 23 PY. Domethënë nuk është kjo që thashë unë apo nuk e keni
- 24 ushtruar profesionin e juristit përpara sesa kyçeshit në UÇK?
- 25 PË. Jo, nuk e kemi ushtru profesionin e juristit se s'kemi

- 1 pas mundësi se shteti s'na ka lënë. Na ka ndjekë, na ka
2 burgosë. Kemi qenë të padëshirueshëm.
- 3 PY. Çfarë trajnimesh keni bërë për ligjet e luftës apo për të
4 drejtën humanitare?
- 5 PË. Trajtime nuk kemi bë, po kemi bë në shkollë që kemi mësu
6 në fakultet. Ka qenë lëndë e veçantë e drejta ndërkombëtare.
- 7 PY. Pra keni mësuar në fakultet disa nga bazat e ligjit të
8 luftës, kështu?
- 9 PË. Në përgjithësi i kemi mësu na ato edhe ato kanë qenë
10 bazike.
- 11 PY. Kishit materiale me shkrim ju për tua dhënë ushtarëve
12 lidhur me ligjet e luftës?
- 13 PË. Jo, s'kemi pas.
- 14 PY. Po a ka ndodhur ndonjëherë në 1998 ose 1999 kur ju
15 përgatitët ndonjë gjë me shkrim përfshirë këtu edhe
16 rregulloren?
- 17 PË. Po, kemi përgatitur një rregullore bashkë me Sadikun sa
18 për -- si udhëzim, si praktikum, qysh me thanë.
- 19 PY. Kur ka ndodhur?
- 20 PË. Kjo ka ndodhur në 1999.
- 21 PY. Të kujtohet muaji?
- 22 PË. Jo.
- 23 PY. Kur thua u bë me Sadikun, e ke fjalën që është bërë në
24 nivel brigade a nivel zone në 1999?
- 25 PË. Në nivel zone.

1 PY. Nga janari deri në prill 1999, ku ishit?

2 PË. Gjatë kësaj kohe kemi qenë në organizim se kemi qenë të
3 shpartallum prej ofensivave të shumta kështu që jemi organizu
4 qysh kemi mujt na nëpër lagje, nëpër shtëpia, nëpër -- derisa
5 jemi bashku dhe kemi fillu pastaj në mënyrë të rregullt.

6 PY. Ku ju drejtuan serbët?

7 PË. S'e kuptoj?

8 PY. Më falni, kur filloi ofensiva serbe?

9 PË. Ofensiva ka pas të njëpasnjishme, po kjo e shtatorit ka
10 qenë shkatërruese për krejt Kosovën në 1998.

11 PY. Dhe shtator brigada dhe batalioni juaj u dëbuan apo jo?

12 PË. Po.

13 PY. Nga shtatori deri në fund të dhjetorit çfarë bëtë ju?

14 PË. Po na jemi rikthye prapë nëpër do vendbanime se s'kemi
15 guxu me nejt nëpër shtëpia. Kështu që jemi kthyer ilegalisht
16 nëpër do vendbanimet të djegura që i ka shkatërruar serbi
17 atëherë, ushtria serbe edhe policia edhe kemi qenë duke u
18 organizu duke u këndell prej shkatërrimit që është bë.

19 PY. Kush e bëri riorganizimin e brigadës?

20 PË. Të gjithë e kanë bërë, secili nga pak. Gur mbi gur është
21 bërë diçka. S'ka pas person të veçantë që e ka bërë
22 organizimin. Të gjithë nga pak kemi ndihmu edhe ka ardhë deri
23 atje.

24 PY. Kur e mësove që brigada ishte ristrukturuar?

25 PË. Atëherë pas janarit, ka shkurti, marsi, atëherë kanë nisë

1 me u bo organizimet. Se kanë qenë të mshefta krejt, për shkak
2 të shkatërrimeve, kanë qenë të mshefta s'kanë mujt me dalë
3 publikisht.

4 PY. Fizikisht, ku ke qenë në janar, shkurt dhe mars?

5 PË. Janar, shkurt dhe mars kam qenë nëpër të afërm të mitë,
6 nëpër celulat e UÇK-së duke u organizuar për betejat e
7 ardhshme.

8 PY. Saktësisht ku ka qenë kjo qeliza e UÇK-së, kjo qeliza e
9 UÇK-së ku keni qenë edhe ju?

10 PË. S'ka pas qelizë, gjithkund kanë qenë grupe-grupe. S'kemi
11 guxu me u përqendru me një vend se ka qenë rrezik për me nejt.

12 PY. Më intereson ku keni qeni ju fizikisht, vetë ju
13 fizikisht, vetëm ju si person, ju individualisht. Ku keni qenë
14 në janar, shkurt dhe mars?

15 PË. Kam qenë në fshatin Grikoc, në fshatin Gjinoc, herë në
16 fshatin Sallagrazhdë, herë në Budakovë, herë në Maqitevë. Të
17 gjitha këto fshatra janë kone dashtë me u organizu. Me u
18 kontaktu me ushtarët të cilët janë -- që janë të shpërndarë në
19 të gjitha anët. Disa prej të cilëve edhe s'janë kthy fare.

20 PY. Në një moment ju rikyçët në zonën e Pashtrikut në
21 Koshterc, kështu?

22 PË. Po.

23 PY. Kur ndodhi kjo?

24 PË. Kjo ka ndodh në mars, prill.

25 PY. Në këtë kohë -- edhe në këtë kohë si këshilltar juridik

1 punuat?

2 PË. Po. Po.

3 PY. Kujt i raportoje?

4 PË. Zakonisht Tahir Sinanit, Tahiri ka qenë komandant i
5 shtabit të zonës.

6 PY. Kur u rikyçët morët ndonjë emërim me shkrim prej Tahir
7 Sinanit?

8 PË. Po, kam pas.

9 PY. Ndër detyrat tuaja, pra detyrat tuaja si këshilltar
10 juridik në prill, a dallonin si detyrat që patët si këshilltar
11 juridik përpara shtatorit?

12 PË. Jo, të njëjtat kanë qenë.

13 PY. Ju nuk keni pasur dijeni se çfarë ka ndodhur në zonën e
14 Pashtrikut sa i takon strukturimit para prillit 1999, kështu?

15 PË. Jo, s'kam pas.

16 PY. A keni qenë pjesë e strukturave të shtabit të zonës të
17 Pashtrikut?

18 PË. Jo, zotëri avokat. S'kam qenë unë strukturë as ushtarake
19 as politike. Unë thjesht kam qenë vetëm këshilldhënës, s'kam
20 qenë kurrfarë vendimmarrësi. Këshilla kam dhënë. Edhe ushtarë
21 kam qenë. Pikësëpari ushtar pastaj këshilla.

22 PY. Ju thoni se s'keni qenë pjesë e strukturave ushtarake. Po
23 a ju kujtohet që në fillim Prokurori të tregoi një
24 organigramë?

25 PË. Po.

1 PY. Një grafik dhe në një kuti atje ishte edhe emri juaj,
2 kështu?

3 PË. Ashtu është. Organigrami ka ekzistuar po sa ka funksionu
4 ajo është problemi. Nuk ka mujt me funksionu. Ka qenë e
5 vështirë funksionimi se organigrami është shumë bukur. Ashtu
6 duket shumë perfekt. Ama kontaktet në mes këtyre personave të
7 caktuar kanë qenë shumë të vërshirësime. Na kemi qenë të
8 përqendrum në vende të caktuara. Si me e marrë sikur lëkurën e
9 leopardit, dikun kemi qenë na, pastaj forcat serbe, pastaj
10 prapë na, pastaj prapë forcat serbe. Kështu që komunikimi mes
11 zonës dhe brigadave ka qenë mjaft i vështirë e le më me
12 batalionet. Po ato kanë ekzistuar në letër, shumë mirë duken. Po
13 faktikisht në funksion janë dobët, dobët, ndoshta dikun edhe
14 hiç. Se për me marrë me çu një lajm ose me marrë një lajm
15 është dashtë me çu korrierin. Korrieri është dashtë me i kalu
16 disa rreziqe, postëblloqe të ndryshme për me arrit deri atje.
17 Kështu që ka qenë ndoshta fare e pamundur një gjë e tillë.

18 PY. Lidhur me strukturën, nga pikëpamja strukturore kujt i
19 jepnit këshilla?

20 PË. Po ne q'aty, në q'at lokalitet ku kemi vepru, a kupton.
21 Q'aty kemi pas, na s'kemi mujt me dalë dikund tjetër për
22 shembull me shku në brigadë ose me shku vetëm me ndonjë farë
23 që ka pas ndonjë problem të vogël kemi mujt me i marrë me fol
24 me atë ushtarin, me e qortu pak, në qoftë se ka ndonjë gabim.
25 Me qit një roje plus. A kupton? Se na kemi pasë të organizum

1 roje e tash në qoftë se për një faj të vogël ose për një
2 fjalosje me dikënd ja kemi caktu edhe një shtesë. në qoftë se
3 ka pas me dalë në roje, një herë në javë, e kemi qit dy herë
4 në javë. Se që me pa një farë rregulli me pas një farë
5 rregulli të thjeshtë në ushtri.

6 Kurrgjë tjetër, s'kemi mujt na me i bo presion sepse ka
7 qenë ushtri vullnetare. Pak me i bo presion ai ikte prej
8 ushtrisë dhe shkojke në shtëpi. S'kemi pas mekanizmat që
9 pengojnë ose detyrojnë me bo diçka. Çdo gjë ka qenë
10 vullnetare. S'ka qenë asgjë me dhunë. Kush s'ka mujt me e
11 diktatë kërrkënd ose me obligu kërrkënd. Po qe se s'i pëlqej ai
12 e ka lonë. Ka qenë specifike ndoshta s'kam ni në botë dikund
13 që ka ushtri vullnetare.

14 PY. Mirë. Po sa i takon këtyre masave disiplinore, në çfarë
15 niveli jepnit ju këto masa disiplinore? Domethënë, jepnit
16 këshilla në nivel zone, në gjithë zonën, në nivel brigade, në
17 nivel batalioni. Pra, në çfarë niveli jepnit këshilla sa i
18 takon masave disiplinore ose për disiplinimin?

19 PË. Po unë e kam pas në nivel të zonës, por na nuk kemi mujt
20 me mrrë kurrë deri në skaj të zonës derisa e ka [E
21 pakuptueshme] q'atë territor. Zona e Pashtrikut ka qenë një
22 ndër zonat më të mëdhaja në Kosovë, kështu që ndoshta na kurrë
23 s'kemi mujt me mbërrë deri te ai ushtari i fundit, te
24 batalioni i fundit, ose te -- kështu që q'atë lokalitet që
25 kemi vepru edhe kemi ushtru veprimtarinë tonë.

1 PY. Pra, nëse ishit në nivel zone dhe duhet të jepnit
2 këshilla lidhur me masat të mundshme disiplinore, kujt ja
3 jepte këshillat konkretisht? Në nivel zone kujt i drejtoheshe
4 ti për t'i dhënë këshillat lidhur me disiplinën?

5 PË. Po na në nivel zone ka pas ushtarë aty. Ushtrisë.
6 Ushtrisë që kanë dalë në pozicione. Kam dalë edhe unë.

7 PY. Po të pyes a i jepje drejtpërdrejt këshillat Tahir
8 Sinanit, i thoje për shembull, që: Unë ju këshilloj të bëni
9 kështu e ashtu?

10 PË. Jo, jo s'kam pas unë prepotencë Tahir Sinanin me e mësu.
11 Kjo ka qenë për ushtarë nuk ka qenë për eprorë.

12 PY. Nuk po them a keni disiplinuar Tahir Sinanin, unë po
13 them, dikush duhet t'i disiplinonte ushtarët.

14 PË. Po në rregull.

15 PY. Pra, komandantët disiplinojnë ushtarët, kështu?

16 PË. Po normalisht komandantët i disiplinojnë ushtarët, por
17 unë i kam përgatit ata, i kam këshillu që mos të hynë në
18 gabimet të cilat janë të këqija të patolerueshme, që nuk duhet
19 me ndodh. Q'atë rol e kam pas unë.

20 PY. Dhe unë po ju pyes tani, ju cilët komandantë këshillonit?
21 A të kujtohen emrat e komandantët që ju jepnit ju këshilla?

22 PË. Prapë po them nuk i kam këshillu komandantët, ushtarët.
23 Ushtarët e thjeshtë. Është dashtë ushtarët që kanë marrë pjesë
24 në luftë.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, shoh që ka

1 ardhur ora.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
3 për sot përfunduar. Do të rifilloni sërish nesër në orën 9.00.
4 Mos flisni me askënd për dëshminë tuaj jashtë sallës së
5 gjyqit. Nëse ju kontakton ndonjë person, lidhur me dëshminë
6 tuaj, na vini në dijeni menjëherë. Shihemi nesër.

7 DËSHMITARI: Okej.

8 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ecën pak
10 më shpjeg sesa çfarë kishim parashikuar. Keni dëshmitar
11 rezervë për këtë javë?

12 Z. PACE: [Përkthim] Pas këtij dëshmitari kemi edhe një
13 tjetër që është gati që të fillojë që nesër. Por nuk kemi
14 dëshmitar tjetër.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
16 sillni dëshmitar nga java tjetër?

17 Z. PACE: [Përkthim] Jo, nuk mundemi sepse dëshmitari
18 javës tjetër nesër fillon seancën përgatitore. Ne kemi
19 respektuar urdhrin tuaj dhe dëshmitari i javës së ardhshme nuk
20 mund të fillojë këtë javë. Kështu që kemi edhe një dëshmitar
21 tjetër rezervë përveç dëshmitarit aktual.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
23 Shihemi nesër në orën 9.00.

24 --- Seanca mbyllet në orën 16.30

25